

BAJRAM XHAFA

**KUSHTET HISTORIKE TË NGRITJES
SË MBRETËRISË SHQIPTARE***

Historia e ngritjes së mbretërisë nga shqiptarët lidhet drejtpërdrejtë me procesin e shtetformimit dhe të pavarësisë së tyre. Shpallja më 1 shtator 1928 e Mbretërisë Shqiptare përmbyll procesin shumë të gjatë e të mundimshëm historik të ngritjes, formësimit e konstituimit të shtetit të pavarur nga shqiptarët në një pjesë të truallit të tyre etnik.

Në periudhën e mesjetës shqiptarët nuk arritën të krijojnë njësi të pavarur shtetërore në nivelin e mbretërisë. Në kuadër të Perandorisë Bizantine, shqiptarët në truallin e tyre krijuan struktura politike autonome në nivelin e principatave, por nuk shkuan më tej. Edhe projekti i Papës Piu II për organizimin e një kryqëzate kundërosmane të komanduar nga Skënderbeu më 1464, me ç'rast do ta kurorëzonte këtë të fundit "mbret" dhe Pal Engjëllin kardinalin e parë shqiptar, më tepër se një nismë e vërtetë politike, duket është sajësë e priftërinjve katolikë shqiptarë Marin Barleti, Pal Engjëlli dhe Dhimitër Frangu nga vjen edhe informacioni për të larë e lustruar politikën e Vatikanit¹.

Edhe në periudhën e ngritjes së nacinalizmave në Evropë shqiptarët nuk arritën as pavarësinë dhe as të formësojnë njësi shtetërore në nivelin e mbretërisë. Jashtë konsideratave të determinizmit gjeografik, pozita gjeografike dhe gjeostrategjike e shqiptarëve në "vijën tektonike" të ballafaqimit midis lindjes dhe perëndimit, përcaktoi fatin e tyre si pjesë e perandorive shumëkombëshe.

Në shekullin XVIII në kuadër të Përandorisë Osmane shqiptarët me Pashallëkun e Shkodrës krijuan gati të parin shtet kombëtar në Ballkan, drejtuar nga Bushatllinjët "*një dinasti sovranësh kombëtarë*", siç e quan Dora d'Istria, me jetëgjatësi treçerek shekullore. Ky qe një rast i shkëlqyer për sigurimin e pavarësisë dhe ngritjen e një mbretërie. Me krijimin më 1785 të *Konfederatës ilirike*, bërthamë e një shteti të tipit konfederatë që shtrihej në pjesën dërmuese në truall shqiptar, në gjithë Gegërinë, përfshi edhe Kosovën, nga Shqipëria venedikase deri në Manastir, Karamahmud Pashë Bushatlliu nënshkruante si

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: "Monarkia Shqiptare, 1928-1939", organizuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 1 shtator 2008.

¹ Kristo Frashëri, *Skënderbeu, Jeta dhe vepra*, Tiranë: 2002, f. 212 - 216.

“qeveritar i Shkodrës dhe i Shqipërisë”², ushtronte një autoritet sovran në atë që Marin Sirdani e quante “Shqynija etnografike” dhe vlerësohej “si princ i Shqipërisë”.

Formacioni politik autonom i Pashallëkut të Shkodrës nën Karamahmudin i kishte elementët e shtetit: territori i përbashkët, popullsia homogjene, organizimi i qëndrueshëm shtetëror dhe një sovranitet i brendshëm. Kështu, para gjithë popujve të tjerë ballkanikë, pa nxitjen dhe mbështetjen e shteteve të Evropës, nxitje dhe ndihmë që më vonë e patën pa kursim grekët, serbë, rumunët, malazezët dhe bullgarët, shqiptarët nën Bushatllinjtë ngritën formacionin e tyre politik në mënyrën më të mirë të mundshme duke siguruar sovranitetin e brendshëm. Mjaftonte një njohje ndërkombëtare nga shtetet evropiane dhe ata do të ishin flamurtarët e pavarësisë nga sundimi osman dhe të shtetësisë në Ballkan me dinastinë e Bushatllinjeve*. Ishte shumë më e lehtë dhe më e arsyetuar nga fuqitë evropiane të njihej pushteti i Karamahmudit të Shqipërisë (familje e fisnikërisë së lartë shqiptare) së Karagjorgjit të Serbisë (një fshatar i thjeshtë, më pas tregtar derrash e që gjatë gjithë jetës mbeti analfabet³).

Gati 100 vjet më vonë, në periudhën e krizës lindore 1875 - 1881 shqiptarët krijuan Lidhjen e Prizrenit, që arriti të formonte qeverinë e përkohshme, thuajse të pavarur nga Porta e Lartë. As në këtë kohë, as Kongresi i Berlinit i “koncertit evropian” dhe as ndonjëra nga fuqitë evropiane veçmas

² Stavri N. Naçi, *Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllinjeve 1757 - 1831*, Tiranë: 1964, f. 184.

* Xhelal Pashës, nip i Mustafa Pashë Shkodrës iu propozua dy herë fronti për mbret të Shqipërisë, prej Ismail Qemalit dhe prej Ahmet Zogut në kohën e pushtimit austriak (1916). Propozimit për ta ngritur flamurin në Shkodër, Ismail Qemali i përgjigjet: “Në Shkodër do të vija po të më printe Xhelal Pasha dhe për këtë ta zgjidhnim mbret të Shqipnisë”. Edhe Ahmet Zogu nëpërmjet përfaqësuesit të tij në Shkodër i propozon më 1916: “Austria do të dalë prej këndeje dhe Shqipnia do të mbetet independente. Mirëpo kjo ka nevojë për një sundimtar të meritueshëm, që edhe populli ta dishrojë. Unë jam i mendjes se personi ma i përshtatshëm për atë kambë kishte me kenë Xhelal Pasha, mbasi dera e tij e ka sundue për shumë vjet Shqipninë. Në këtë pikë jemi dakort edhe me Aqif Pashën edhe me Prekë Pashën. Po të pranojë Xhelal Pasha, kishim për t’i dalë para edhe për ta vu në fron të Shqipnisë” (Hamdi Bushati, *Shkodra dhe motet II*, Shkodër: “IDROMENO”, 1999, f. 349, 467.

³ Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, Tiranë: “Çabej”, 1996, f. 263. Protagonisti i Kryengritjes së Dytë serbe Milosh Obrenoviçi, që cilësohet si themelues i vërtetë i Serbisë dhe krijues i dinastisë së dytë serbe, dikur lopçar analfabet, ka hyrë në historinë e vendit të tij si Miloshi i Madh, Milosh Veliki (*Po aty*, f. 276).

nuk e njohën as kombin shqiptar dhe as “çështjen shqiptare”^{**}, ndërkohë që Serbisë dhe Malit të Zi u trajtuan ndryshe.

Vetëm në periudhën e Luftërave Ballkanike më 1912 - 1913, nga halli i Luftës së Parë të përbotshme që po trokiste, çështja shqiptare u vu në tryezën e bisedimeve të diplomacisë evropiane. Shpallja e Pavarësisë krijoi kushtet për vendosjen e një monarku. Qeveria e Përkohshme e Vlorës në mbledhjen e 8 dhjetorit 1912, duke caktuar programin e komisionit që do të mbronte çështjen shqiptare para Fuqive të Mëdha vendosi që ky të kërkonte: ngritjen në Shqipëri të një monarkie kushtetuese me një mbret nga vendet evropiane⁴. Kërkesa pasqyrore realizmin politik të qeverisë së Vlorës. “Vetëm gjatë shekullit të tanishëm (shek. XX - B. Xh.), shkruan anglezi J. Swire, shqiptarët arritën të fitonin një njohje ngurruese të së drejtës së tyre për ekzistencë të pavarur dhe ruajtjen e një pjese të vogël të së drejtës së parëlindjes së tyre”⁵.

Më 29 korrik 1913 Konferenca e Ambasadorëve të gjashtë Fuqive të Mëdha të Evropës mori vendimin që e shpallte *Shqipërinë autonome, sovranë dhe trashëgimore* (neni 1); *çdo lidhje suzeraniteti me Turqinë përjashtohet* (neni 2); *Shqipëria bëhet shtet asnjans nën garancinë e Fuqive të Mëdha* (neni 3), por *shteti shqiptar vihet nën kontrollin e tyre*⁶. Bashkë me të Konferenca shtroi edhe nevojën e sjelljes së një princi si kryetar të këtij shteti të stërcunguar si nga pikëpamja e territorit edhe nga ajo e attributeve. Historia e kandidatëve të princit të ardhshëm të Shqipërisë është një romancë më vete. Në nëntor 1913 Fuqitë e Mëdha pranuan përfundimisht që princ i Shqipërisë të ishte gjermani **Vilhelm fon Vid** (Wilhelm von Wied) i propozuar nga Austro - Hungaria dhe Italia. Kështu, nën qiellin e nxirë nga retë e Luftës së Parë Botërore që po afrohej, në Shqipërinë “e pavarur” u vendos të ngrihej një regjim ksenokratik apo një kondominium ndërkombëtar i përbërë nga dy pjesë që u ngjanin kokave të dy përbindshave të cilët donin të shqyenin njëri tjetrin.

Dihet fati dramatik i Principatës Shqiptare të Vidit. Agresioni ushtarak grek në Jug të vendit në trajtën e “lëvizjes” për “autonominë e vorioepirit” dhe kryengritja rebele e Fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme më 1914, nuk e lanë Princin evropian as gjashtë muaj në fronin shqiptar (7 mars - 3 shtator 1914). Të shtyrën përfundimtare ia dha fillimi i Luftës së Parë Botërore. Në thelb Princin e hoqën ata që e vunë. Faktet provuan se çështja e princit që një zgjidhje efemere (jetëshkurtër), diktuar nga trysnia e rrethanave. Largimi i tij dhe shkatërrimi i shtetit shqiptar qenë fryti më i shpejtë dhe i drejtpërdrejtë i

^{**} Në Kongresin e Berlinit më 1878 Bismarku që ishte edhe kryetar i Kongresit pati deklaruar prerë: “Nuk ka kombësi shqiptare” (Joseph Swire, *Shqipëria ngritja e një mbretërie*, Tiranë: “Dituria”, 2005, f. 24).

⁴ *Historia e Shqipërisë III*, Tiranë: 1984, f. 88.

⁵ J. Swire, *vep. e përm.*, f. 12.

⁶ *Historia e Shqipërisë III...*, f. 106.

Konferencës së Ambasadorëve për të cilën diplomati amerikan Xhorxh F. Wiliams shkruante më 1914: “Nga ky akord i Londrës doli një ngatërrësë sa nuk bëhej më e madhe dhe më e keqe”⁷. Monarkun shqiptar diplomacia evropiane e bëri “gazin e botës”, ashtu siç pat thënë për të me cinizëm perandori Vilhem II i Gjermanisë para se ai të nisej në detyrën e sovranit shqiptar.

Më 3 shtator 1914 princi Vilhelm dhe princesha shkuan në Lugano dhe prej andej në Gjermani. “Bashkatdhetarët e mi, shkruan Ismail Qemali, e panë me trishtim të largohej, sikur ai të përfaqësonte një shpresë që po vdiste, një ëndërr që zhdukej”⁸. Ndonëse sundimtar i një shteti asnjë, pa patur asnjë detyrim, Vidi u bashkua me ushtrinë gjermane në shtabin e një divizioni të frontit lindor. Gjatë pushtimit austro - hungarez të Shqipërisë, për shkak të qëndrimit të tij lidhur me asnjësinë e Shqipërisë, kthimi i tij nuk gjeti mbështetje.

Edhe pse Lufta Botërore kishte dy vjet që kishte përfunduar dhe Konferenca e Paqes kishte një vit që rropatej në punën e saj, më 1920 Shqipëria vazhdonte të ishte e pushtuar nga ushtri të huaja dhe e ngarkuar me problemin e pazgjidhur të statusit shtetëror e të kufijve të saj. Kongresi kombëtar i Lushnjës në janar 1920, që mori përsipër t’i zgjidhë ato, miratoi një akt kushtetues, “Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë” ose Statuti i Lushnjës, ku përcaktohej sovraniteti i plotë i shtetit shqiptar, i shprehur nga organet që zgjodhi vetë kongresi. Për të qenë konformitet me vendimin e 29 korrikut 1913 të Konferencës së Ambasadorëve, si formë të shtetit kongresi caktoi *monarkinë*. Vendin e monarkut do ta zinte Këshilli i Lartë (Regjenca) prej 4 vetësh i cili do të përfaqësonte kryetarin kolektiv të shtetit, derisa ky, ashtu si edhe forma e regjimit të përcaktoheshin përfundimisht nga një asamble kushtetuese. Anëtarë të këtij këshilli u zgjodhën: Aqif Pashë Elbasani, Mihal Turtulli, Luigj Bumçi, dhe Abdi Bej Toptani. Edhe Statuti i Zgjeruar i Lushnjës i shpallur më 8 dhjetor 1922 sanksiononte regjimin monarkik të vendosur në Shqipëri qysh me Princ Vidin më 1914. Çështja se kush do të ishte mbret i Shqipërisë u la e pazgjidhur për shkak të mosmarrëveshjeve dhe ndërlikimeve politike që mund të sillte.

Ushtrimi i kompetencave të mbretit, përkohësisht dhe në masë të kufizuar përsëri iu la Këshillit të Lartë (Regjencës) prej katë vetësh, siç ishte vendosur në Lushnjë. Anëtarët e tij do të zgjidheshin nga Këshilli Kombëtar për tre vjet. Prania e Këshillit të Lartë u përkrah nga të gjitha forcat politike.

Kongresi i Lushnjës la detyrë për të ardhmen mbledhjen e Asamblesë Kushtetuese, caktimin e formës së regjimit dhe hartimin e kushtetutës. Më 27 dhjetor 1923 përfunduan zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese e cila filloi punimet më 21 janar 1924. Punën e saj për zhvillimin politik të vendit në rrugë kushtetuese (konstitucionale) e ndërpreu Revolucioni i Qershorit 1924 dhe ardhja në fuqi me grusht shteti e qeverisë revolucionare të Fan Nolit.

⁷ Xhorxh F. Wiliams, *Shqiptarët*, Tiranë: “Argeta - LMG”, 1999, f. 45.

⁸ Ismail Qemal Vlora, *Kujtime*, Tiranë: “Toena”, 1997, f. 327.

Revolucioni i Qershorit dhe qeveria e Fan Nolit (qershor - dhjetor 1924) nuk shpalli ndonjë ndryshim të formës së shtetit.

Pas rënies së qeverisë së Nolit dhe “Triumfit të Legalitetit” më 24 dhjetor 1924, Asambleja Kushtetuese e shpërndarë u mblodh dhe më 21 janar 1925 shpalli si formë të shtetit republikën. Forma republikane, Republika e Parë Shqiptare, edhe kjo vepër e Ahmet Zogut, vazhdoi deri në vitin 1928. Që nga viti 1912 protagonizmi i Zogut në politikën shqiptare si prijës politik dhe ushtarak i nacionalizmit shqiptar erdhi duke u rritur me një ritëm të çuditshëm megjithëse shumë i ri në moshë. Por sidomos përballja e suksesshme me ngjarjet më të rëndësishme dhe më kritike për fatet e Shqipërisë së re në vitet 1920 - 1925 e bëri atë figurën e padiskutueshme në qiellin e politikës shqiptare. Roli kryesor që luajti në organizimin dhe sigurimin e veprimtarisë së Kongresit Kombëtar të Lushnjës, veprimtaria e tij si figura kryesore e qeverisë së Sulejman Delvinës në postin e ministrit të Brendshëm për bashkimin e territoreve të pushtuara nën qeverinë e re, organizimi i Luftës çlirimtare së Vlorës, Koplikut e Dibrës kundër agresionit të shovinistëve fqinj, asgjësimi i lëvizjes esatiste dhe asaj separatiste të Mirditës; asgjësimi i grushtit të shtetit të dhjetorit 1921 dhe rebelimit të Marsit 1922, menaxhimi i ngjarjeve gjatë dhe pas Revolucionit të Qershorit dhe “Triumfit të Legalitetit” etj. e ngritën Zogun në atë shkallë sa me të drejtë iu dha titulli “Shpëtimtar i Kombit”.

Shpallja e Republikës dhe zgjedhja e Zogut si Presidenti i parë i saj është vlerësuar unanimisht si zgjidhja politike më e zgjuar e më realiste për kohën. Por forma republikane kishte mospërputhje me statusin fillestar të shtetit shqiptar të vendosur nga një organ ndërkombëtar kur ai u njoh si subjekt i së drejtës ndërkombëtare. Konferenca e Ambasadorëve të Londrës që bëri njohjen e parë ndërkombëtare të shtetit shqiptar më 29 korriku 1913 mori vendimin që e shpallte *Shqipërinë autonome, sovrane dhe trashëgimore* (neni 1), pra, *monarki*.

Veç kësaj, me gjithë ritmet e shpejta të ngritjes së institucioneve shtetërore dhe të rritjes së qëndrueshmërisë politike në vend, për kushtet e Shqipërisë si shtet i ri, sistemi republikan bartte rreziqet e krizave politike sa herë të ndërrohej kreu i shtetit, shkaktuar nga diversioni i jashtëm dhe nxitjet e brendshme. Forma republikane e qeverisjes nuk ofronte siguri të plotë, që ishte aq e nevojshme për një shtet të ri që sapo kishte dalë nga anarkia. Shqipëria kishte nevojë për një qeverisje të qëndrueshme që do të inkurajonte popullin për t’iu vënë punës dhe për të ngritur një shtet me themele të forta.

Nevoja për konsolidimin më të mirë të shtetit dhe sigurimin e një stabiliteti politik afatgjatë nëpërmjet një harmonizimi më të qëndrueshëm e më solid të interesave të klasave e shtresave të ndryshme të shoqërisë shqiptare dhe mbi të gjitha domosdoshmëria e forcimit të karakterit kombëtar të shtetit të parë shqiptar në këtë periudhë të krijimit të shteteve nacionale, i shtynë forcat

politike atdhetare shqiptare në mendimin e urtë e largpamës të kalimit të shtetit në **formën mbretërore, në monarki**. Gjithashtu ata projektuan ngritjen e një **dinastie vendase** (nënvizimi im - B. Xh.). Edhe gjendja e brendshme e vendit, traditat historike dhe mendësia e popullit shqiptar krijonin avantazhe për monarkinë.

Lidhjet me Italinë nëpërmjet paktit të Parë dhe të Dytë të Tiranës më 1926 dhe 1927 i mbeti Zogut si e vetmja rrugë për rritjen e sigurisë së brendshme nga anarkia dhe pastabiliteti. Kjo kishte shkaktuar shqetësim edhe në Evropë se mos përballë kërcënimit jugosllav, Shqipëria po binte nën kthetrat italiane dhe kështu pavarësia e saj po i dorëzohej Italisë. “Ndërkohë që po korrtë përfitimet nga miqësia me Italinë, Shqipëria të mos humbiste asnjë mundësi për të ripohuar ...sovrانيتin dhe pavarësinë e saj, një politikë që Italia, duke i pasur të siguruarat interesat e saj jetike, nuk kishte arsye ta kundërshtonte”⁹.

Kthimi në monarki ishte një nevojë politike, por shprehte edhe vazhdimësi historike. Shpesh ky kalim është shpjeguar si kthim tek sistemi i vjetër dhe sidomos me ambicjet personale për pushtet vetiak të Ahmet Zogut duke shmangur zgjedhjet periodike siç ndodhte një regjim republikan. Për më tepër këtë model qeverisje kishin edhe vendet e rajonit dhe shumica e vendeve të qytetëruara të Evropës.

Mirëpo Princ Vidi nuk kishte abdikuar, ruante të “drejtat” e veta dhe nuk kishte hequr dorë kurrë nga pretendimet e tij për fronin. Por Princi i huaj nuk e lidhi fatin e tij politik me fatin e popullit dhe të vendit, sovran të të cilit e caktuan. Veshja e çizmeve të ushtarit gjerman në Luftën Botërore e komprometoi dhe e shkëputi tërësisht nga lidhjet me fatin e Shqipërisë. Një monark vendas do të evitonte shfrytëzimin e ndonjë situatë politike që mund të favorizonte pretendimet e Vidit për fronin shqiptar, gjë të cilën ai e priste. Ky rastdo të shkaktonte tëheqjen e Shqipërisë në aleancat e ardhshme që kishin filluar të konturoheshin, me më shumë mundësi drejt Fuqive të Boshtit. Kjo do të sillte pasoja të rënda politike për Shqipërinë në zhvillimet e ardhshme politike.

Këtyre faktorëve historikë e politikë të brendshëm e të jashtëm u vjen në ndihmë edhe ai që jemi mësuar ta quajmë faktori subjektiv, faktor i cili lidhet në radhë të parë me emrin dhe veprën atdhetare të Ahmet Zogut, politike dhe luftarake. Pa u zgjatur në konsideratat e larta dhe vlerësimet e shumta pozitive të bashkëkohësve për të, do të thoshim se emri i tij kishte qenë “i caktuari nga fati” (shprehje e Konicës) jo vetëm për ta krijuar e ngritur shtetin shqiptar, por edhe atë të dinastisë mbretërore.

Vendosja e monarkisë u diktua jo vetëm nga nevoja madhore të karakterit politik e historik, të brendshme e të jashtme, por edhe nga disa nevoja imediate për rregullime kushtetuese të kohës. Statuti i Republikës që funksionoi deri më 1928, kishte të meta serioze sepse nuk parashikonte disa organe të rëndësishme

⁹ J. Swire, *vep. e përm.*, f. 402.

shtetërore si: kryeministri, këshilli i shtetit etj. Prandaj, më 1 qershor 1928, kryetari i Republikës Ahmet Zogu i drejtoi Asamblesë Ligjvënese (të dyja dhomave të parlamentit) një mesazh për të vendosur rishikimin e Statutit Themeltar të Republikës në një sesion të jashtëzakonshëm. Në përgjigje të mesazhit, Asambleja u mbledh më 7 shtator dhe konkludoi se: “Shqipnija e 1928 nuk asht ajo e viteve 1924 e 1925 e prandaj edhe Statuti, që asht ba për nevojat e atëhershme, nuk i përshtatet Shqipnisë së sotme”. Ajo miratoi këtë shtojcë të nenit 141: “Rishikimi i përgjithshëm i Statutit i përket Asamblesë Kushtetuese. Kur vendoset nevoja e rishikimit të përgjithshëm të Statutit, simbas procedurës së caktueme në këtë nen, të dy dhomat quhen vetvetiu të shpërndame dhe dekretohen zgjedhje për Asamblenë Kushtetuese, simbas nenit 47 të Statutit”. Po në këtë mbledhje, të dyja dhomat e parlamentit vendosën nevojën për rishikimin e përgjithshëm të Statutit e rrjedhimisht, shpërndarjen e tyre.

Pas kësaj, kryetari i Republikës dekretoi zgjedhjet për në Asamblenë Kushtetuese të cilat u bënë më 17 gusht 1928 sipas sistemit të tërthortë dyshkallësh. Asambleja Kushtetuese filloi punën më 25 gusht, ndërsa më 27 gusht filloi të shqyrtonte projekt-statutin e ri ku si formë e shtetit ishte përcaktuar monarkia. Zgjedhësit e dytë të disa nënprefekturave, kur shkuan të votonin për anëtarët e Asamblesë, kishin kërkuar ndërrimin e formës së shtetit nga republikë në mbretëri. Propozimi i parë doli nga nënprefektura e Skraparit e cila kërkoi për mbret Zogun. Zogu ishte i vendosur në respektimin e parimeve të së drejtës kushtetuese.

Në vendim thuhej: “Asambleja Konstituante e mveshun me fuqinat sovraane të Kombit, e inspiruar prej dëshirës së shquar të popullit, për interesat vitale t’Atdheut, në mbledhjen me datë 1 shtatuer 1928, dita e Shtunë ora 9.12 me një za e një shpirt zgjedh e proklamon:

MBRET (Roi) TË SHQIPTARVET, nën emrin ZOG I birin të dalun prej gjirit të vet, shpëtimtarin e kombit “Ahmet Zogun” zbritun prej familjes së famshme ZOGU”¹⁰

Pas shpalljes së mbretërisë, më 5 shtator 1928 u formua qeveria me kryeministër Koço Kotën. Pasi përfundoi shqyrtimin dhe miratimin e “Statutit Themeltar të Mbretnis Shqiptare” më 1 dhjetor 1928, Asambleja Kushtetuese u kthye në Parlament. Në të njëjtën datë hyri në fuqi “Statuti Themeltar”.

Në këtë mënyrë mori fund procesi i gjatë e i mundimshëm, plot vështirësi, therori e pengesa të jashtëzakonshme të jashtme e të brendshme; ai i përfundimit të krijimit të shtetit shqiptar në kohën moderne; përfundoi ai proces që aq bukur e poetikisht është formuluar në titullin kuptimplotë të një vepre historike për Shqipërinë nga historiani anglez J. Swire: “ALBANIA: The Rise of a Kingdom”- “Shqipëria, ngritja e një mbretërie”.

Shpallja e Mbretërisë Shqiptare nuk ishte një ngjarje e rastit dhe e veçuar nga gjithë procesi i zhvillimit historik të popullit shqiptar. Ajo ishte kurorëzim i

¹⁰ *Statuti Themeltar i Mbretnisë Shqiptare*, Tiranë, 1929, f. 37.

luftërave dhe përpjekjeve shekullore të shqiptarëve për liri e pavarësi kombëtare, për bashkimin e tyre në njësinë shtetërore sipas parimit të mirënjohur: “Një komb, një atdhe, një shtet”.

Megjithë pozitën e veçantë të vështirë politike dhe historike në Ballkan, në planin e brendshëm ngritja e Mbretërisë Shqiptare ka qenë ndryshimi më konsensual mbarëpopullor dhe pa konflikte shoqërore. Zhurmat e emigracionit politik të viteve ‘20 - ‘30 vinin nga cytjet e huaja dhe egoizmi politik, gjë që shihet edhe nga kujtimet e mëvonshme të shumë prej tyre (Sejfi Vllamasi, Mustafa Kruja etj.). Kjo e bën monarkinë shqiptare krejt të ndryshme nga ajo e shumë vendeve fqinje.

Shpallja e Mbretërisë Shqiptare përbën pikën kulmore në historinë tonë kombëtare. Ajo mbylli një epokë të tërë luftërash e përpjekjesh shekullore për të hequr qafe zgjedhën e huaj, për të siguruar tërësinë territoriale të atdheut e për të formuar shtetin e lirë kombëtar shqiptar, duke kurorëzuar aspiratën dhe veprën e Rilindjes e të Pavarësisë. Rrethanat e ngritjes së Mbretërisë Shqiptare, shkruan Swire, “japin shpjegimin dhe përligjen e një ngjarjeje kulmore në rilindjen e Shqipërisë¹¹”

Me shpalljen e Mbretërisë, shteti shqiptar mori një fizionomi të plotë kombëtare. Karakteri kombëtar i shtetit shqiptar gjen mishërim të plotë në ligjin themelor të shtetit, në “Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare” të vitit 1928, i cili apelon kombin dhe obligon shtetin shqiptar me misionin madhor të bashkimit kombëtar. Në paragrafin hyrës (në vend të preambulës) fiksohet në formë deklarate kushtetuese “dëshira e patundshme e plot gjallni e Kombit Shqiptar për forcimin e përrjetshëm të **bashkimit kombëtar** (nënvizimi - B.Xh.) dhe për sigurimin e zhvillimit paqsor t’Atdheut e të mirës së përgjithshme të popullit, tue respektue traditat historike të Kombit, të cilat padyshim i sigurojnë brezit t’ardhshëm një mbarëvajtje të meritueshme¹²”.

Mbretëria Shqiptare u njoh shpejt nga shumë shtete të mëdha e të vogla. Në radhë të parë kishte rëndësi njohja nga Fuqitë e Mëdha. Vetëm Jugosllavia pati një reagim të fortë për shkak të titullit “Mbret i Shqiptarëve” kuptohej si shtrirje e kujdesit dhe përgjegjësisë edhe mbi shqiptarët e Kosovës e të viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi. Shqipëria kishte një pozitë krejt të veçantë historike dhe politike në rajon ku gjysma e bashkëkombasve të saj në trojet e veta ndodhej jashtë kufijve politikë të shtetit shqiptar dhe banonte në shtetet fqinje. Por edhe Jugosllavia e njohu ndryshimin.

Vonesa historike e shpalljes së Mbretërisë Shqiptare lidhet me qëndrimin e Fuqive ndaj çështjes shqiptare. A do të ishte qëndrimi i tyre edhe për Mbretërinë një “njohje ngurruese” kalimtare apo një politikë afatgjatë. Fillimi i LDB e futi përsëri çështjen shqiptare në frigoriferin e historisë dhe bashkë me të edhe çështjen e Mbretërisë. Çështja shqiptare në një formë të re doli në sipërfaqe në fundin e shekullit XX. Po çështja e Mbretërisë?

¹¹ J. Swire, *vep. e përm.*, f. 402.

¹² *Statuti Themeltar i Mbretërisë ...*, f. 3.